



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:** ISHP Qendra për Shëndet Publik Manastir

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë për vitin 2020

**Qëllimi i revizionit:** Të fiton bindje të arsyeshme nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në raportet financiare janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura relevante.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- e drejta e patransferuar e përdorimit të objekteve ndërtimore;
- rritja e vlerës së përgjithshme të mjeteve materiale pa dokumentacion mbështetës dhe
- harmonizimi i pa kryer i evidencave materiale dhe kontabilitetit me gjendjen faktike të mjeteve materiale.

### Mendimi i dhënë \*:

Është shprehur mendim me rezervë në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

### Rekomandimet kyçe:

- inicimi i procedurës për marrjen e Vendimit për të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të pronës së patundshme dhe regjistrimin e saj në kadastrën e patundshmërive;
- zbatimi i regjistrimit që do të sigurojë harmonizimin e kontabilitetit me gjendjen faktike të mjeteve dhe
- miratimi i regjistrimit dhe llogarisë përfundimtare dhe dorëzimi i tij në institucionet kompetente në afatet e përcaktuara me ligj.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë aktivitete për rishikimin e zgjidhjeve ligjore dhe mundësive për zbatimin dhe funksionalizimin e sistemit nacional për punën materialo-financiar dhe kontabilitet në ISHP dhe të Sistemit Qendror për evidentim e orarit të punës.

Është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë aktivitete për kontrollin e jashtëm të cilësisë së shërbimeve laboratorike, të cilat i referohen vendosjes së kontrollit të cilësisë së shërbimeve laboratorike në institucionet shëndetësore private dhe publike.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror.

\*  pozitive,  me rezervë,  të pavolitshme,  të përmbajtur